

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture

Ministry of Infrastructure

Prishtinë 01.02.2018

Në bazë të neneve 4,21,22 Të Ligjit nr. 03/L-089 mbi Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr 82, 21 tetorë 2010), si dhe në bazë të nenit 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 17 të Rregullorës nr. 02/2011 mbi fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 25 të Ligjit mbi vetëqeverisjen Lokale, si dhe Ligjit nr.05/L-071 mbi Buxhetin e Kosovës për vitin 2016 lidhet ky:

ANEKS - MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM NË MES MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE KOMUNËS SË GJAKOVËS

Neni 1

Palët Nënshkruese

1. **Ministria e Infrastrukturës**, e përfaqësuar nga Ministri i MI-së, (në tekstin e mëtejshëm MI)
2. **Komuna e Gjakovës**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejshëm Komuna).

Neni 2

Aneksi është pjesë përbërëse e marrëveshjes për bashkëfinancim nr. MI/KM 2701/14 të datës 04.08.2014 të lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Gjakovës.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i Aneks Marrëveshjes është rirregullimi i vlerave financiare të projekteve pas nënshkrimit të kontratës:

1. **Asfaltimi i rrugës Bardhaniq - Dashinoc**, kodi i projektit nr.14720 në vlerë prej **572,430.00 €** (pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjet euro).

Neni 4

Pika 1.2 e Nenit 1 të Marrëveshjes plotësohet dhe ndryshohet si vijon:

- Ministria e Infrastrukturës do të financoj projektin në shumën e tërësishme të kontratës në shumë prej **572,430.00 €** (*pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjet euro*).

Neni 5

Pjesa tjetër e tekstit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Gjakovës mbetet e pa ndryshuar.

Neni 6

Hyrja në fuqi


Palët nënshkruese janë pajtuar që ky Aneks i Memorandumit të Mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Numri i Kopjeve

Ky Aneks i Memorandumit të Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje identike dhe atë nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

Ministri i MI-së

Pal Lekaj



Kryetari i Komunës

Ardian Gjini

